**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644-19-4015-5-2-1/C190**
**14 Nr. 794/19**
**Dt. 21.08.2019**

# KONTRATË PUNE

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj** – Drejtoreshë për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejmë **POROSITËSI**) , dhe

2. **" Gurëbardhi "sh.p.k. ( emri i biznesit ) me Nr.UI: 811243211 me seli në Klinë & " Alko – Impex General Construction "sh.p.k. ( emri i biznesit )** me **NRB: 70086447 e NRF : 600115746** seli në **Prishtinë,** të cilët i përfaqëson me autorizim, **z. Veton Elshani**, në tekstin e mëtejmë: KRYESI I **PUNËVE,** janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për punët e shënuara me poshtë:

**Lot. 2 : Ndërtimi i 10 ( dhjetë ) rrugëve me kubza betoni** , me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prokurimi Nr. | VU644 | 1 | 9 | 40 | 1 | 5 | 5 | 2 | 1 |
| Prokurimi Nr. | 644 | 1 | 9 | 0 | 6 | 2 | 5 | 2 | 1 |

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Ndërtimi i 10 ( dhjetë ) rrugëve me kubza betoni** , sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues **: 644-19-062-521.**

1.2 **Afati i fillimit të punimeve është** 3 ( tri ) ditë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.

1.3 Projekti do të realizohet brenda periudhës 45 ditë pune, sipas kushteve të kontratës të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

1.4 Kryesi i punimeve ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Porositësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.

1.5 Kryesi i punimeve do të penalizohet me shumën prej 0,10% të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të kryerjes së punëve të papërfunduara deri në një shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **84.960,30€ ( tetdhejtekatërmijnënqindegjashtëdhjet/30Euro).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen : **në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.**

2.4 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimit Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.

**Neni 3Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

(f) Plani për menaxhimin e kontratës;

(g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit

(h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e këtij kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[1] në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

---

[1] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Saranda Cakaj |
| **Pozita:** | Drejtoreshë për Prokurim Publik |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 21.08.2019 |
| **Vula:** | |

**Për Kontraktuesin:**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Veton Elshani |
| **Pozita:** | Përfaqësues me autorizim i Kontraktuesit: " Gurëbardhi "sh.p.k. & " Alko Impex General Construction " - Klinë |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 21.08.2019 |
| **Vula:** | |

Numri i prokurimit: VU644-19-4015-5-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-062-521 Titulli: Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni - Lot 2 **Ndërtimi i dhjetë (10) rrugëve me kubëza betoni**

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 18, 8 apo 0, e jo në formatin ~~18% apo 8% apo 0%,~~
Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, çmimi duhet shkruar me dy decimale pasë presjes dhjetore

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhët të përfshijë: Blerjën, furnizimin,transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit ne gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve te prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i terë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion.

| *Nr.* | *Përshkrimi i pozicioneve* | *Njësia Matëse* | *Sasia* | *Çmimi për njësi pa TVSH* | *Norma e TVSH-së në %* | *Çmimi për njësi (me TVSh)-€* | *Totali (Pa TVSH)* | *TVSH* | *Totali (me TVSH)-€* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *I* | *Ndërtimi me kubëza betoni:*<br>*1. Rruga "OSMAN E SHABAN BUNJAKU" (L=260m', b=4m)*<br>*2. Rruga "FAIK KONICA" (L=260m', b=5m)*<br>*3. Rruga "HALIM BEHRAMI" (L=180m', b=4m)*<br>*4. Rruga "HASHIM KOLLA" (L=120m', B=4m)*<br>*5. Rruga "HAZIRA GERGURI" (L=300m', b=4,5m)*<br>*6. Segmenti i rrugës "VËLLËZRIT VESELI" (L=120m', b=4m)*<br>*7. Rruga "HASAN RASHICA" (L=160m', b=4m)*<br>*8. Rruga "IGBALLE PRISHTINA" - VAZHDIM (L=130m', b=3,5m)*<br>*9.Segmenti i pare i rruges "LUTFI MUSIQI "L=85m'*<br>*10. Segmneti i rrugës "DAUT IMERI" L=130m' b=3,0m'* | | | | | | | | |
| 1 | Shenimi I trases ne rruge para fillimit te punimeve dhe percjellja e tyre | m' | 1,745.00 | 0.42 | **18.00** | **0.50** | 739.41 | 133.09 | **872.50** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Pastrimi I terenit ne ter gjeresin dhe gjatesin e rruges duke perfshir largimi I tyre deri ne deponin ku e cakton organi mbikqyres | m' | 1,745.00 | 0.42 | **18.00** | **0.50** | 739.41 | 133.09 | **872.50** |
| 3 | Germimi I dheut te kategoris se III dhe IV sipas vendit, ne trashesi t=20cm ne llogari hyn dhe bartja deri ne deponi per ter gjatesin dhe gjeresine rruges | $m^3$ | 785.25 | 1.27 | **18.00** | **1.50** | 998.20 | 179.68 | **1,177.88** |
| 4 | Rrafshimi I nen bazes me grejder dhe ngjeshja me cilinder deri ne ngjeshje te plote prej 50 N/mm 2 | $m^2$ | 7,852.50 | 0.17 | **18.00** | **0.20** | 1,330.93 | 239.57 | **1,570.50** |
| 5 | Furnizimi me materjal prej gurit te thyer (0-63)mm me trashesi ne gjendje te ngjeshur t=20 cm ngjeshja te behet me rrul cilindrik duke perdorur edhe vibratorin MSH=70 MN/M2 ne ter gjatesin e rruges | $m^3$ | 1,570.50 | 5.93 | **18.00** | **7.00** | 9,316.53 | 1,676.97 | **10,993.50** |
| 6 | Furnizimi me materjal prej gurit te thyer (0-31.5)mm me trashesi ne gjendje te ngjeshur t=10 cm ngjeshja te behet me rrul cilindrik duke perdorur edhe vibratorin MSH=80 MN/M2 ne ter gjatesin e rruges | $m^3$ | 785.25 | 5.93 | **18.00** | **7.00** | 4,658.26 | 838.49 | **5,496.75** |
| 7 | Furnizimi me materjal zhavor fraksion (0-4)mm me trashesi ne gjendje te ngjeshur t=5.0 cm ngjeshja te behet me rrul cilindrik duke perdorur edhe vibratorin MSH=80 MN/M2 ne ter gjatesin e rruges | $m^3$ | 392.63 | 7.63 | **18.00** | **9.00** | 2,994.64 | 539.03 | **3,533.67** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | Furnizimi dhe vendosja e kubzave ne trashesi t=8cm formen dhe dizajnin e percakton organi mbikqyres ( Atestet e Kubzav te prezentohen para fillimit te punimeve duhete plotesu kushetein e 25 cikluseve ) | $m^2$ | 8,725.00 | 5.08 | **18.00** | **6.00** | 44,364.41 | 7,985.59 | **52,350.00** |
| 9 | Furnizimi me materjal te nevojshem , kapake metalik , konusa betoni 800/600 dhe ngritja e tyre ne nivelin e rruges me kubza | copë | 87.25 | 16.95 | **18.00** | **20.00** | 1,478.81 | 266.19 | **1,745.00** |
| 10 | Furnizimi dhe vendosja e skajorve me dim. 15/18/24m sidhe punimi I bazes me beton per vendosjen e tyre .( Atestet e Skajorve te prezentohen para fillimit te punimeve duhete plotesu kushetein e 25 cikluseve ) | m' | 1,745.00 | 2.54 | **18.00** | **3.00** | 4,436.44 | 798.56 | **5,235.00** |
| 11 | Furnizimi me materjal të nevojshem dhe kyqja individuale me gypa PVC Ø110 mm me te gjitha materjalet përcjellëse në gjatësi mesatare L=15m' , në këtë pozicion është përfshirë edhe puna e dorës si hapja e kanilit dhe kyqja në puseta të kanlizimit fekal. | copë | 22.00 | 2.54 | **18.00** | **3.00** | 55.93 | 10.07 | **66.00** |
| 12 | Hartimi I projekti detal nga ana e kompanise,pas perfundimit te projektit "ASB Draiwing",duke perfshi te gjitha elemente percjellse te niveletes situacion,gjatsot,terthor,diagrami I mbushjeve,diagrami I germimeve, etj). | m' | 1,745.00 | 0.51 | **18.00** | **0.60** | 887.29 | 159.71 | **1,047.00** |
| | **TOTALI I:** | | | | | | **72,000.25** | **12,960.05** | **84,960.30** |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) | |
|---|---|
| **EMRI I OE:** | GUREBARDHI SHPK |
| **EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:** | VETON ELSHANI |
| **NËNSHKRIMI:** | |
| **DATA:** | 18.07.2019 |
| **VULA:** | Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar GUREBARDHI Klinë |